

Nr. 2305/44 K (e-k) Prot.
Tiranë, më datë 17/05/2023

Drejtuar: Komisionit Qendror të Zgjedhjeve
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
z. Ilirjan CELIBASHI

Lënda: **KONSTATIME** – Raporti XVII i
Gjetjeve dhe Rekomandimeve për
periudhën 5 - 14 maj 2023, lidhur
me raportimet në ndërfaqen e
raportimeve të KQZ-së të
veprimtarive me karakter publik
të institucioneve publike,
agjencive dhe/ose ndërmarrjeve
shtetërore.

I Nderuar z. Komisioner!

Të nderuar Kolegë të Administratës së KQZ-së!

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin në vazhdimësi, mund të gjeni në vijim Gjetjet dhe Rekomandimet e Raportit të fundit të monitorimit të KRIIK për periudhën 5 maj – 14 maj 2023, i cili **përmbledh funksionimin e mekanizmit të raportimit të institucioneve në ndërfaqe, veprimtaritë publike të zhvilluara që mund të përbëjnë shpërdorim të burimeve shtetërore, si dhe respektimin e heshtjes zgjedhore.**

Gjatë monitorimit të kësaj jave, KRIIK ka evidentuar disa problematika, si:

1. Raportimi i aktiviteteve me vonesë
2. Veprimtari publike të zhvilluara, por të pa raportuara
3. Përdorimi hashtag-eve sloganë elektorale: #VetëmPërpara #KurrëMëMbrapa në FAQET ZYRTARE FACEBOOK TË BASHKIVE
4. Thyerja e heshtjes zgjedhore nëpërmjet reklamave politike aktive online
5. Thyerja e heshtjes zgjedhore nëpërmjet intervistave publike
6. përdorimi i burimeve publike për fushatë elektorale nga kryetari i bashkisw tiranw

Konkretisht:

1. RAPORTIMI I AKTIVITETEVE ME VONESË

Praktika e raportimit të aktiviteteve me vonesë vijon.

Nga monitorimi rezulton se **rreth 17.6% e raportimeve në kwtw periudhw janë me vonesë.**

Specifikisht, nga 51 aktivitete të raportuara gjatë kësaj periudhe, 9 janë raportuar me vonesë (për më shumë shih **Lidhjen 1**, e cila përmbledh të dhënat për raportimet me

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailing address:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

vonesë, si dhe **Lidhjen 2** me listën e detajuar të këtyre aktiviteteve, së bashku me të dhënat përkatëse referuar ndërfaqes së aktiviteteve në faqen e internetit të KQZ-së).

Numri total i institucioneve raportuese përgjatë periudhës kohore që mbulon ky raport është 16, nga të cilat 7 kanë raportuar së paku një aktivitet përtej afatit të përcaktuar ligjor. Ritheksohet se këto shifra i referohen vetëm raportimeve të kryera nga institucionet në ndërfaqe dhe që mund të aksesohen aty. Nëse në KQZ kanë mbërritur raportime me anë të postës elektronike, apo me mjete të tjera të komunikimit dhe nuk janë hedhur në ndërfaqe, këto nuk përfshihen në të dhënat e mësipërme.

2. VEPRIMTARI PUBLIKE TË ZHVILLUARA, POR TË PA RAPORTUARA

Nga monitorimi jo sistematik i faqeve zyrtare të disa institucioneve në mediat sociale, si dhe i mediave të tjera online lidhur me pasqyrimin e aktiviteteve të tyre të mundshme, gjatë periudhës 5 maj – 14 maj 2023, rezulton se **së paku 3 veprimtari publike nuk janë raportuar në ndërfaqen e KQZ-së**. Këto veprimtari janë kryer nga 3 institucione, sipas **Lidhjes nr. 4** bashkëlidhur këtij raporti. (për më tepër gjeni bashkëlidhur **Lidhjen nr. 3** me listën e këtyre aktiviteteve së bashku me informacione shtesë të pasqyrimeve mediatike që provojnë realizimin e tyre).

Lidhur me këtë konstatim, ritheksohet se ai bazohet në gjykimin se këto aktivitete nuk janë raportuar, pasi ato nuk pasqyrohen në informacionin e bërë publik në ndërfaqen e KQZ-së, si edhe se me shumë gjasë numri i aktiviteteve të pa raportuara është më i lartë, pasi gjetjet bazohen në një monitorim të kryer në mënyrë jo sistematike.

3. PËRDORIMI HASHTAG-EVE SLOGANË ELEKTORALË: #VETËMPËRPARA #KURRËMËMBRAPA NË FAQET ZYRTARE FACEBOOK TË BASHKIVE

Me aktivitetin e hapjes së fushatës elektorale nga Partia Socialiste, në datën 11 prill 2023, kjo e fundit bëri publike edhe sloganin e fushatës elektorale për zgjedhjet e datës 14 maj 2023. Konkretisht, sloganin e fushatës #VetëmPërpara #KurrëMëMbrapa. (shih për më shumë: [“PS çel fushatën, Rama: Krenar për vlerën e shtuar që fitoret tona sollën për Shqipërinë”](#))

Në vijim të monitorimit KRIIK ka vërejtur se këto slogane kanë shoqëruar postimet e kryera në faqet zyrtare të disa bashkive, konstatime këto të përcjell tashmë nëpërmjet denoncimeve përkatëse në KQZ.

Nga monitorimi edhe përgjatë kësaj jave KRIIK ka vërejtur se disa bashki vijnë me postime në rrjetet sociale të shoqëruara nga këto **hashtag-e lidhen dhe identifikojnë drejtpërsëdrejt Subjektin Zgjedhor “Partia Socialiste”**.

Duke u vendosur, përdorur dhe reklamuar nga institucionet publike dhe drejtuesit e tyre në faqet zyrtare në Facebook, në gjykimin e KRIIK kemi të bëjmë me shpërdorim të autoritetit shtetëror, si dhe përdorim:

- të një asemi institucional (specifikisht të Faqes Zyrtare të Institucionit në mediat sociale, e cila përdoret gjerësisht si kanal komunikimi publik);

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailing address:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

- të kohës së nëpunësve shtetërorë (personat e ngarkuar me mirëmbajtjen dhe shpërndarjen e njoftimeve në këto faqe);

- si dhe të gjithë burimeve të tjera të vëna në dispozicion për realizimin e aktivitetit institucional, të cilave iu jepet valencë politike dhe iu atashohet në mënyrë të padrejtë një meritë partiake në funksion të një partie politike, çka është në kundërshtim me kuadrin ligjor zgjedhor, si dhe të parimit për ndarjen e shtetit nga partia.

Ky fenomen vërehet në disa faqe të institucioneve apo edhe drejtuesve të tyre.

Një faqe bëhet me karakter zyrtar kur ajo shpallet apo trajtohet si e tillë nga informacioni që ajo transmeton dhe përmbajtja që ka.

Në rast se **faqja shfaq dhe përmban tërë aktivitetin institucional të institucionit dhe është burim informacioni për tërë të tretët dhe publikun e gjerë, atëherë ajo është një faqe zyrtare.**

Konkretisht:

3.1. Postime të shoqëruara me përdorimin e hashtag-eve të sipërpërmendura gjenden në Faqet Zyrtare të dy Bashkive dhe tek faqja zyrtare e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, konkretisht:

1. [Faqja zyrtare](#) e Bashkisë Mat;
2. [Faqja Zyrtare](#) e Bashkisë Dibër;
3. [Faqja zyrtare](#) në Facebook e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;

Të gjitha rastet e postimeve të mësipërme, të detajuara me link-et dhe printscreen-et përkatëse, gjenden bashkëlidhur në ***Lidhjen nr. 5***.

Në vijim të qëndrimit të tij, **KRIIK jua paraqet këtë denoncim si indicie juve si institucion i KQZ-së.**

Sipas gjykimit të KRIIK, nevojitet që rastet të merren në konsideratë prej jush e vazhduar me ndjekjen e procedurave të parashikuara për sanksionimin e shkelësve sipas ligjit.

Gjithashtu, **KQZ-ja nevojitet të sanksionojë përpos titullarëve të institucioneve edhe subjektin zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, e cila është përfituesja kryesore nga ky aktivitet i ndaluar (neni 172 i Kodit Zgjedhor).**

4. THYERJA E HESHTJES ZGJEDHORE NËPËRMJET REKLAMAVE POLITIKE AKTIVE ONLINE

Address:
Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailing address:
P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

Kodi Zgjedhor, neni 77 ka përcaktimet ligjore lidhur me heshtjen zgjedhore. Konkretisht pika 2 përcakton “*Dita përpara datës së zgjedhjeve dhe data e zgjedhjeve, deri në orën e mbylljes së votimit, formojnë periudhën e heshtjes zgjedhore. Në periudhën e heshtjes zgjedhore nuk lejohet asnjë lloj fushate zgjedhore nëpërmjet organeve të medias, si dhe zhvillimi i mitingjeve ose i veprimtarive të tjera zgjedhore të subjekteve zgjedhore*”.

Me nisjen e heshtjes zgjedhore, KRIIK ka monitoruar një numër faqesh onine dhe [Librarinë e Reklamave Politike](#) të Meta për reklama ende aktive në ditën e heshtjes zgjedhore.

Ndërkohë që vlerësohet pozitivisht se pjesa më e madhe e partive politike dhe kandidatëve i kanë ç'aktivizuar reklamamat politike në Facebook dhe Instagram, KRIIK evidentoi një numër faqesh që vijuan të kenë reklama aktive ditët e heshtjes zgjedhore, në 13 dhe 14 maj 2023 (lutemi gjeni më poshtë listën e emrave të këtyre faqeve si dhe në **Lidhjen nr. 6** bashkëlidhur linkun përkatës dhe printscreen te faqes, për secilën faqe, ku shihet se reklamamat vijuan të ishin aktive).

Lista e faqeve/profileve në Facebook që kishin reklama aktive ditët e heshtjes zgjedhore, në 13 dhe 14 maj 2023 në thyerje të heshtjes zgjedhore:

1. Belind Këlliçi
https://www.facebook.com/ads/library/?active_status=all&ad_type=political_and_issue_ads&country=AL&vieë_all_page_id=975204015836064&search_type=page&media_type=all
2. Dashmir Shehi
https://www.facebook.com/ads/library/?active_status=all&ad_type=political_and_issue_ads&country=AL&vieë_all_page_id=752572328256708&search_type=page&media_type=all
3. Lëvizja Bashkë
https://www.facebook.com/ads/library/?active_status=all&ad_type=political_and_issue_ads&country=AL&vieë_all_page_id=117170505075144&search_type=page&media_type=all
4. Oltion Çaçi
https://www.facebook.com/ads/library/?active_status=all&ad_type=political_and_issue_ads&country=AL&vieë_all_page_id=114190684953563&search_type=page&media_type=all
5. Luçiano Boçi
https://www.facebook.com/ads/library/?active_status=all&ad_type=political_and_issue_ads&country=AL&vieë_all_page_id=321721261302808&search_type=page&media_type=all
6. Nisma #Thurje
https://www.facebook.com/ads/library/?active_status=all&ad_type=political_and_issue_ads&country=AL&vieë_all_page_id=165747223634454&search_type=page&media_type=all
7. Klevis Balliu
https://www.facebook.com/ads/library/?active_status=all&ad_type=political_and_issue_ads&country=AL&vieë_all_page_id=1789186294744514&search_type=page&media_type=all
8. Sofije Kryeziu Alushaj
https://www.facebook.com/ads/library/?active_status=all&ad_type=political_and_issue_ads&country=AL&vieë_all_page_id=104140849249455&search_type=page&media_type=all
9. Lumturi Hasa
https://www.facebook.com/ads/library/?active_status=all&ad_type=political_and_issue_ads&country=AL&vieë_all_page_id=100794708782671&search_type=page&media_type=all

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailing address:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

10. Besnik Dushaj
https://www.facebook.com/ads/library/?active_status=all&ad_type=political_and_issue_ads&country=AL&vieë_all_page_id=102114922707998&search_type=page&media_type=all
11. Pashk Gjoni
https://www.facebook.com/ads/library/?active_status=all&ad_type=political_and_issue_ads&country=AL&vieë_all_page_id=113016018317343&search_type=page&media_type=all
12. Behar Haxhiu
https://www.facebook.com/ads/library/?active_status=all&ad_type=political_and_issue_ads&country=AL&vieë_all_page_id=110394928661453&search_type=page&media_type=all
13. Eriselda Zotaj Ƈelaj
https://www.facebook.com/ads/library/?active_status=all&ad_type=political_and_issue_ads&country=AL&vieë_all_page_id=163942883659796&search_type=page&media_type=all
14. Aleanca Progresiste LZHK
https://www.facebook.com/ads/library/?active_status=all&ad_type=political_and_issue_ads&country=AL&vieë_all_page_id=330064997696921&search_type=page&media_type=all
15. Elvis Hajderli
https://www.facebook.com/ads/library/?active_status=all&ad_type=political_and_issue_ads&country=AL&vieë_all_page_id=108460318877707&search_type=page&media_type=all
16. Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet
https://www.facebook.com/ads/library/?active_status=all&ad_type=political_and_issue_ads&country=AL&vieë_all_page_id=284923454880724&search_type=page&media_type=all
17. Hysni Sharra
https://www.facebook.com/ads/library/?active_status=all&ad_type=political_and_issue_ads&country=AL&vieë_all_page_id=101400625384681&search_type=page&media_type=all
18. Dr. Endrit Shabani:
https://www.facebook.com/ads/library/?active_status=all&ad_type=political_and_issue_ads&country=AL&vieë_all_page_id=302792163188883&search_type=page&media_type=all
19. Zija Ismaili
https://www.facebook.com/ads/library/?active_status=all&ad_type=political_and_issue_ads&country=AL&vieë_all_page_id=103037632648010&search_type=page&media_type=all
20. Emirjana Sako
https://www.facebook.com/ads/library/?active_status=all&ad_type=political_and_issue_ads&country=AL&vieë_all_page_id=102575978326449&search_type=page&media_type=all
21. Ledina Alolli
https://www.facebook.com/ads/library/?active_status=all&ad_type=political_and_issue_ads&country=AL&vieë_all_page_id=101096172886527&search_type=page&media_type=all

Address:Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana**Mailing address:**P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

Në gjykimin e KRIIK, nevojitet që rastet të merren në konsideratë prej jush si KQZ e ndaj subjekteve politike apo kandidatëve që kishin reklama aktive të procedohet

sipas parashikimeve ligjore, me sanksionet përkatëse për thyerjen e heshtjes zgjedhore.

5. THYERJA E HESHTJES ZGJEDHORE NËPËRMJET INTERVISTAVE PUBLIKE

Kodi Zgjedhor, neni 77 ka përcaktimet ligjore lidhur me heshtjen zgjedhore. Konkretisht pika 2 përcakton “*Dita përpara datës së zgjedhjeve dhe data e zgjedhjeve, deri në orën e mbylljes së votimit, formojnë periudhën e heshtjes zgjedhore. Në periudhën e heshtjes zgjedhore nuk lejohet asnjë lloj fushate zgjedhore nëpërmjet organeve të medias, si dhe zhvillimi i mitingjeve ose i veprimtarive të tjera zgjedhore të subjekteve zgjedhore*”.

Me nisjen e heshtjes zgjedhore, KRIIK monitoroi daljet publike të përfaqësuesve të subjekteve zgjedhore në media, dhe konstatoi se disa përfaqësues apo kandidatë nëpërmjet intervistave në media kryen **thirrje politike duke thyer kështu heshtjen zgjedhore.**

Konkretisht:

1. Z. Belind Këlliçi në një prononcim për mediat pasi votoi shprehet:

“Atëherë mirëmëngjes, faleminderit të gjithëve për pasqyrimin dhe për interesin e treguar. Sapo kreva detyrën time si qytetar, votova. Ftoj të gjithë qytetarët e Tiranës që të shkojnë sot në qendrat e tyre të votimit për të kryer detyrën e tyre si qytetarë, për të votuar. Ftoj të gjithë të rinjtë, të gjithë ata mijëra e mijëra qytetarë që në këto 5 muaj kam takuar duke shtrënguar duart e duke i parë në sy dhe duke folur për ndryshim. Sot është dita e madhe. Sot është 14 maji që e kemi pritur aq shumë që të gjithë. Është dita ku keni në dorë fatin e këtij qyteti, dhe ndryshimin e keni vet në duar. Ndaj kam një apel mbi të gjitha për rininë, për rata që përherë e kam thënë, për nacut e Tiranës, për të gjithë ata që e kuptojnë atë që po u them. Për të gjithë vajzat, djemtë, gjithë të rinjtë që kanë një moment në të cilin mendojnë se duhet të ikin nga ky qytet, apo e kanë më të lehtë për të menduar që mund të marrin një kamion për të ikur nga Tirana, apo mund të marrin gomone për të ikur i them JO. Hajdeni votoni! Hajdeni bashkë të ndryshojmë të ardhmen e qytetit tonë. Për të gjithë ato punë të pabëra, për të gjitha ato abuzime që kemi parë në këto 8 vite, për të gjitha ato shpresa që janë shuar këto 8 vite, për të gjithë ata qytetarë që janë larguar, për të gjithë ata të afërmit tuaj që janë larguar, dilni dhe votoni, mos harroni. Askush nuk ju kontrollon dot votën. As Belind Këlliçi dhe as Erion Veliaj. Ftoj të gjithë qytetarët të vijnë te kutitë e votimit, të shkojnë në dhomat e fshehta, të votojnë me ndërgjegje të pastër. Të votojnë për të ardhmen e fëmijëve të tyre, për të ardhmen e familjeve së tyre dhe të votojnë për 4 vitet e ardhshme. Unë e them dhe njëherë, e kreva detyrën time. Tashmë do të shkoj në selinë qendrore të partisë demokratike. Jam duke marrë informacione nga të gjithë qendrat e votimit në Tiranë. Deri tani përpos disa gjërave të vogla teknike, procesi është duke shkuar normalisht. I bëj thirrje dhe njëherë qytetarëve, Dilni, dilni votoni masivisht. Sot është një ditë feste, për të gjithë ata që më kanë thënë në këto muaj kur po vjen dita e ndryshimit, sot është dita e ndryshimit, 14 Maji. Dilni dhe votoni. Faleminderit të gjithëve!”

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailing address:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

Fjala e plotë është trasmetuar nga disa media:

EuroNews https://www.youtube.com/watch?v=DSvULO2_V74&t=97s

Top Channel <https://top-channel.tv/video/top-channel-voton-belind-kellici-apel-qtytareve-sot-eshte-dita-e-madhe-e-ndryshimit/>

RTV Klan https://www.youtube.com/ëatch?v=YBxY60u_rFM

1. **Z. Enkelejd Alibeaj** në një prononcim për mediat pasi votoi shprehet:

“Votova për pak minuta sepse besoj se zgjedhja është e lehtë për këdo sot, por kam një mesazh për të gjithë demokratët, për gjithë shqiptarët e ndershëm, për gjithë shqiptarët e lirë. Sot do të duhet të ushtrojnë të drejtën e tyre kushtetuese të votës në mënyrë të qetë, në mënyrë të matur për të bërë një ndarje me të shkuarën. Sot është dita në fakt, sot është dita që shqiptarët, ata të cilët kohë më parë kanë refuzuar votimit, sot do të duhet të vijnë sepse sot është dita për të bërë një ndarje të madhe me të shkuarën dhe kjo është në dorë të shqiptarëve.”

Fjala e plotë është trasmetuar nga disa media:

EuroNews <https://www.youtube.com/watch?v=Ec51RQVgjII>

RTV Klan <https://www.youtube.com/watch?v=3ExsqeTRyYY>

Report TV <https://www.youtube.com/watch?v=Ddu8v2d0zBO>

2. **Z. Sali Berisha** në një prononcim për mediat pasi votoi shprehet:

“Kjo është pranvera e ndryshimit! Nesër Shqipëria arkivon përfundimisht monizmin e shëmtuar Së pari, një thirrje nga zemra për të gjithë qytetarët shqiptarë, të flasin sot me votën e tyre për qeverisjen vendore. Të gjithë ata të cilët u ftuan nga armiku i egër i votës së lirë të shqiptarëve, që të rrinë në shtëpi, të mos harrojnë se ky është një nxitje, një apel i madh që ata të marrin pjesë sot në votime. Ai që ka frikë votën, ai ka frikë lirinë dhe është armik i saj. Së dyti, ftoj të gjithë zgjedhësit shqiptarë, të mos harrojnë se përsëritja e të njëjtit gabim, e bën gabimin edhe më të madh. Ndaj dhe le t’u prijë mençuria e tyre, në mënyrë që të votojnë në interesin më të mirë të tyre, familjes së tyre, vendit të tyre. Kjo është pranvera e ndryshimit! Nesër Shqipëria arkivon përfundimisht monizmin e shëmtuar dhe kjo është një ditë fitoreje për demokracinë shqiptare”.

Fjala e plotë është trasmetuar nga disa media:

RTV Klan <https://www.youtube.com/watch?v=np5c1byW3bY>

RTSH <https://www.youtube.com/watch?v=L4-vqlzu5OY>

3. **Z. Flamur Golemi**, kandidat i PS për kryetar të Bashkisë Gjirokastrë, në një prononcim për mediat pasi votoi shprehet:

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailing address:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

“Shiu ƐshtƐ mbarƐsi dhe bereqet, por ƐshtƐ dhe ditƐ festive, dhe sot ƐshtƐ njƐ ditƐ feste pƐr GjirokastrƐn. UnƐ I bƐj thirrje tƐ gjithƐ qytetarƐve GjirokastritƐ tƐ shprehin vullnetin e vet dhe sigurisht tƐ vazhdojnƐ tƐ gjithƐ sƐ bashku ta bƐjmƐ kƐtƐ qytet alternativƐ tƐ parƐ pƐr tƐ gjithƐ tƐ rinjtƐ dhe tƐ rejat. Dhe besoj fort se tƐ gjithƐ sƐ bashku do tƐ ecim pƐrpara. ShumƐ faleminderit edhe mbarƐ!”

Fjala e plotƐ ƐshtƐ trasmetuar nga media:

RTV Klan <https://www.youtube.com/watch?v=BkRbK5VkmeY>

4. **Z. Fisnik Qosja** kandidat i BashkƐ FitojmƐ pƐr kryetar tƐ BashkisƐ KavajƐ, nƐ njƐ prononcim pƐr mediat pasi votoi shprehet:

“I falƐnderoj pa masƐ qytetarƐt e KavajƐs pƐr gjithƐ mbƐshtetjen qƐ na kanƐ dhƐnƐ gjatƐ fushatƐs. FalƐnderoj Ɛdo qytetar tƐ KavajƐs dhe mbƐshtetƐs pƐr njƐ fushatƐ model gjatƐ kƐtij muaji. UnƐ besoj qƐ sot Kavaja ƐshtƐ nƐ kƐmbƐ pƐr t’i prirƐ ndryshimit, kƐtƐ absolutisht e ka vendosur Ɛdo qytetar sepse Kavaja ka nevojƐ pƐr tƐ ndryshuar kurs dhe kursi po vjen. 14 maji sot dita ƐshtƐ qƐ Kavaja tƐ shkojƐ atje ku e meriton. QytetarƐt tƐ dalin masivisht nƐ votime dhe t’i prijnƐ ndryshimit”.

Fjala e plotƐ ƐshtƐ trasmetuar nga media:

News 24 <https://www.balkanweb.com/voton-kandidati-fisnik-qosja-kavaja-eshte-ne-kembe-per-ti-prire-ndryshimit-qytetaret-te-dalin-masivisht-ne-votime/>

5. **Z. Roland Bejko** kandidat i PartisƐ Demokratike pƐr kryetar tƐ BashkisƐ TiranƐ, nƐ njƐ prononcim pƐr mediat pasi votoi shprehet:

“Sot ƐshtƐ njƐ ditƐ e rƐndƐsishme pƐr demokracinƐ shqiptare i ftoj tƐ gjithƐ qytetarƐt e TiranƐs qƐ tƐ dalin nƐ votime. Sot ƐshtƐ njƐ ditƐ ku ata duhet tƐ shprehen, tƐ shprehen pƐr krye bashkiakun qƐ duan tƐ zgjedhin dhe pƐr ekipin qƐ do tƐ drejtojƐ bashkinƐ e TiranƐs nƐ kƐshillin e BashkisƐ. ƐshtƐ njƐ ditƐ shumƐ e madhe pƐr demokracinƐ vendore dhe njƐ vend ka aq demokraci sa ka demokraci vendore kƐshtu qƐ tƐ drejtƐn e votƐs sot shqiptarƐt duhet ta ushtrojnƐ masivisht. E dyta ƐshtƐ qƐ ƐshtƐ rasti sot qƐ nƐse qytetarƐt janƐ tƐ mƐrzitur nga klasa e vjetƐr politike dhe njƐ pakice oligarkƐsh qƐ menaxhojnƐ pronat, pasuritƐ etj., ƐshtƐ dita qƐ qytetarƐt e TiranƐs tƐ shprehen kundƐr tyre. Sot ƐshtƐ dita ta refuzojnƐ kapjen e tregut tƐ TiranƐs nga oligarkia politike, krimi i organizuar dhe oligarkia financiare. Oligarkia nƐ TiranƐ njihet me emƐr, qƐ me Sajmirin etj. Projekti ynƐ pƐr TiranƐ, do tu kthejƐ TiranƐn qytetarƐve, ne do tƐ mbrojmƐ pronƐn, do tƐ zhvillojmƐ turizmin, ekonominƐ dhe pƐrmirƐsojmƐ shƐrbimin.”

Fjala e plotƐ ƐshtƐ trasmetuar nga media:

Report TV <https://www.youtube.com/watch?v=0lcxkDMcqVU>

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailing address:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

NƐ gjykimin e KRIIK, **KQZ-ja duhet t’i marrƐ nƐ konsideratƐ dhe nƐ shqyrtim kƐto raste** dhe ndaj subjekteve politike apo kandidatƐve qƐ kryen fushatƐ elektorale nƐpƐrmjet **thirrjeve tƐ tyre gjatƐ ditƐs sƐ zgjedhjeve tƐ procedojƐ sipas parashikimeve ligjore, me sanksionet pƐrkatƐse pƐr thyerjen e heshtjes zgjedhore.**

6. PËRDORIMI I BURIMEVE PUBLIKE PËR FUSHATË ELEKTORALE NGA KRYETARI I BASHKISW TIRANW

Më datë 10.05.2023 Kryetari i Bashkisë Tiranë dhe kandidati i Partisë Socialiste për kryetar në këtë bashki (subjekt zgjedhor), ka zhvilluar një vizitë në një çerdhe të ndërtuar rishtaz në njësinë nr. 14 në Bashkinë Tiranë.

Në këtë vizitë z. Veliq ka qenë i shoqëruar nga z. Plarent Ndreca, Drejtues Politik i Partisë Socialiste për Njësinë nr.14 dhe Njësinë Kashar në Tiranë.

KRIIK nuk ka arritur të gjejë në ndërfaqen e raportimeve një njoftim për këtë aktivitet, pra figuron qw veprimtaria të jetë e pa raportuar, nga Bashkia Tiranë.

Njoftimi për zhvillimin e kësaj veprimtarie është postuar në profilin zyrtar të kryetarit të Bashkisë Tiranë dhe drejtuesit politik të PS në atë zonë, z. Plarent Ndreca.

Konkretisht:

Postimi në faqen e [Kryetarit të Bashkisë Tiranë](#) (më poshtë përmbajtja dhe foto/printscreens e faqes):

“Jam shumë i lumtur që hapim sot çerdhen e re, “Bota e Fëmijë...”

*Jam shumë i lumtur që hapim sot çerdhen e re, “Bota e Fëmijëve” ,
në zonën e Astirit, për t’i dhënë zgjidhje prindërve të 170 fëmijëve
. Ofrojmë të njëjtin shërbim si në të gjitha çerdhet e tjera të Tiranës
sepse për ne familja dhe fëmijët janë më të rëndësishëm.”*




Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailing address:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania



Një postim në faqen e tij Facebook lidhur me këtë aktivitet ka bërë edhe [z. Plarent Ndreca](#), Drejtues Politik i Partisë Socialiste për Njësinë nr.14 dhe Njësinë Kashar në Tiranë.


“ ÇERDHJA MË E RE NË NJËSINË 14 [#LagjaRilindja](#) [#Astir](#)

“Bota e fëmijëve” ambienti i shumpritur për banorët e zonë i çerdhës publike.

Sot bashkë me Erionin, Zhanetën dhe Gentin inaguruam hapësirën e re të investimit.

Tirana ecën përpara !

[#PS](#) [#Njesia14](#) [#VetemPerpara](#) [#KurrePas](#)”



Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailing address:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania



Nga videot dhe fotografitë e publikuara, duket qartë prezenca edhe e fëmijëve në këtë vizitë në çerdhe, si dhe drejtoresha e institucionit dhe edukatoret.

Duke qenë se aktiviteti nuk është i raportuar në ndërfaqen e KQZ, nuk është e qartë nëse kemi të bëjmë me një aktivitet të z. Veliaj në pozicionin e Kryetarit të Bashkisë Tiranë, apo të z. Veliaj si Subjekt Zgjedhor, Kandidat për Kryetar të Bashkisë Tiranë.

Në gjykimin e KRIIK, aktiviteti, **pavarësisht nëse është institucional apo në kuadër të fushatës zgjedhore, përbën përdorim të burimeve publike dhe autoritetit shtetëror në funksion të fushatës elektorale të Subjektit Zgjedhor z. Erion Veliaj dhe Subjektit Zgjedhor “Partia Socialiste”.**

Kodi Zgjedhor në nenin 81 pika 3 jep kuptimin e një veprimtarie elektorale përgjatë fushatës zgjedhore, e konkretisht: **“Veprimtaria ndjek qëllime elektorale kur ajo synon promovimin e arritjeve institucionale, të investimeve, inaugurimeve ose ecurinë në ndërtimin e punëve publike ose kur promovon aspekte specifike të programit elektorale të subjektit zgjedhor”.**

Ndërsa në nenin 91 pika 1 dhe 2, Kodi Zgjedhor përcakton se: **“Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia. 2. Në kuptim të këtij neni, “burime” quhen asetet e luajtshme dhe të paluajtshme, të parashikuara në nenin 142 të Kodit Civil, si dhe çdo burim njerëzor i institucionit. Me përdorim të “burimeve njerëzore” kuptohet përdorimi i detyruar në fushatë zgjedhore i administratës së institucionit brenda orarit të punës për qëllime zgjedhore, si dhe përdorimi i detyruar dhe i organizuar brenda orarit mësimor i nxënësve të sistemit shkollor parauniversitar në fushatë zgjedhore. Me përdorim të burimeve njerëzore kuptohet gjithashtu premtimi ose ofrimi i përfitimeve nëpunësve publikë, ose nxënësve për të marrë pjesë në veprimtari që lidhen me fushatën zgjedhore jashtë orarit të punës ose mësimin, si dhe ushtrimi i presionit ndaj tyre për këtë qëllim”.**

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailing address:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

Lidhur me gjithë sa më sipër, edhe nëse kjo veprimtari do të pretendohet e konsiderohet si:

(A) një takim me natyrë elektorale, atëherë evidentohen më poshtë këto shkelje:

1. Përdorimi i institucionit publik dhe kryerja e një aktiviteti institucional inagurimi të çerdhes, për efekt të aktivitetit elektorale.
2. Aktiviteti është kryer qartas gjatë orarit zyrtar të punës.
2. Pjesëmarrësit në të janë fëmijët e çerdhes, çka përbën përdorim të fëmijëve për qëllime elektorale.
3. Pjesëmarrës janë drejtoresha dhe edukatoret e çerdhes në orarin zyrtar të punës, duke përdorur punonjësit e institucionit për qëllime elektorale.

Bazuar në sa më sipër, në gjykimin e KRIIK, aktiviteti objekt denoncimi është zhvilluar në shkelje të qartë të kuadrit ligjor dhe si i tillë, **KQZ-ja nevojitet të sanksionojë titullarët e Çerdhes, Kandidatin-Subjekt Zgjedhor z. Erion Veliqaj, si dhe Subjektin Zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, e cila është përfituesja kryesore nga ky aktivitet.**

(B) si i karakterit institucional, atëherë evidentohen më poshtë këto shkelje:

1. Aktiviteti është i pa raportuar në ndërfaqen e KQZ.
2. Aktiviteti është inagurim, sepse çerdhja është e re, e sapo hapur dhe në statusin e publikuar nga vetë z. Veliqaj theksohet “*Jam shumë i lumtur që hapim sot çerdhen e re, “Bota e Fëmijëve”, në zonën e Astirit, për t’i dhënë zgjidhje prindërve të 170 fëmijëve”.*
3. Aktiviteti është inagurim apo promovim, çka në kuptim të nenit 81 pika 3 dhe nenit 91 pika 1 dhe 2, të Kodit Zgjedhor është një aktivitet i ndaluar për t’u zhvilluar, gjatë periudhës zyrtare të fushatës zgjedhore
4. Prania e z. Plarent Ndreca, Drejtues Politik i Partisë Socialiste për Njësinë nr.14 dhe Njësinë Kashar në Tiranë, i jep natyrë elektorale aktivitetit.
5. Pjesëmarrësit në të janë fëmijët e çerdhes, për takimin dhe shfaqjen/publikimin e fotove të të cilëve nuk dihet nëse ka dakordësi paraprake nga prindërit, dhe për këtë KQZ-ja lipset të marrë informacion.

Aktiviteti wshtw trasmetuar gjerwisht edhe nga media. Konkretisht disa prej tyre janë:

Top Channel <https://www.youtube.com/watch?v=Afuu77fTCcI>

Report TV <https://www.youtube.com/watch?v=sztXYN1hhrU>

RTSH <https://www.youtube.com/watch?v=WLDHVH4CAGE>

Referuar gjithë sa më sipër, në çdo rast të çfarëdo pretendimi të ngritur dhe të marrjes apo jo në konsideratë prej KQZ-së, në gjykimin e KRIIK, aktiviteti objekt denoncimi është zhvilluar në shkelje të kuadrit ligjor dhe si i tillë, **nevojitet që KQZ-ja nevojitet të sanksionojë titullarët e Çerdhes, Kryetarin e Bashkisë z. Erion Veliqaj, si dhe subjektin zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, e cila është përfituesja kryesore nga ky aktivitet.**

Duke ju falënderuar edhe njëherë për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin në vazhdimësi,

Me konsideratë,

**Për Koalicionin Për Reforma, Integrim
dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK)**

**Premto Gogo
Kryetar**

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailing address:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania